

**DRAFT METODOLOGJIA PËR IDENTIFIKIMIN E SHËRBIMEVE TË
OPERATORËVE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE DHE TË RËNDËSISHME
TË INFORMACIONIT**

Përmbajtja

Lista e Figurave.....	5
Lista e Tabelave	6
1 HYRJE	7
2 QËLLIMI	8
3 OBJEKTI.....	8
4 PËRKUFIZIME	8
5 BAZA LIGJORE	9
6 HAPAT E IDENTIFIKIMIT DHE KLASIFIKIMIT TË SHËRBIMEVE / INFRASTRUKTURAVE TË INFORMACIONIT	10
7 KRITERI I PËRGJITHSHËM	11
8 IDENTIFIKIMI I SEKTORËVE DHE NËNSEKTORËVE.....	12
9 PËRCAKTIMI I PRAGJEVE NË NIVEL SEKTORIAL	14
9.1 Energjia.....	14
9.1.1 Përshkrimi.....	14
9.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	14
9.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale	15
9.1.4 Skema	15
9.2 Transporti.....	16
9.2.1 Ajror.....	16
9.2.1.1 Përshkrimi.....	16
9.2.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale.....	16
9.2.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale	16
9.2.1.4 Skema	17
9.3 Hekurudhor.....	18
9.3.1 Përshkrimi.....	18
9.3.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	18
9.3.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale	18
9.3.4 Skema	19
9.4 Detar	19
9.4.1 Përshkrimi.....	19
9.4.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	19
9.4.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale	20
9.4.4 Skema	21
9.5 Rrugor.....	21
9.5.1 Përshkrimi.....	21

9.5.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	21
9.5.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	22
9.5.4	Skema	22
9.6	Spektori Financiar	23
9.6.1	Bankar.....	23
9.6.1.1	Përshkrimi.....	23
9.6.1.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale.....	23
9.6.1.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	24
9.6.1.4	Skema	25
9.6.2	Infrastruktura e Tregjeve Financiare	25
9.6.2.1	Përshkrimi.....	25
9.6.2.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale.....	25
9.6.2.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	26
9.6.2.4	Skema	27
9.7	Shëndetësia.....	27
9.7.1	Përshkrimi.....	27
9.7.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	27
9.7.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	28
9.7.4	Skema	29
9.8	Furnizimi me Ujë të Pijshëm	30
9.8.1	Përshkrimi.....	30
9.8.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	30
9.8.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	30
9.8.4	Skema	31
9.9	Ujërat e zeza	31
9.9.1	Përshkrimi.....	31
9.9.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	31
9.9.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	32
9.9.4	Skema	32
9.10	Infrastruktura Digjitale	32
9.10.1	Përshkrimi.....	32
9.10.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	33
9.10.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	33
9.10.4	Skema	34
9.11	Menaxhimi i Shërbimeve TIK.....	35

9.11.1	Përshkrimi.....	35
9.11.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	35
9.11.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	35
9.11.4	Skema	36
9.12	Administrata Publike	37
9.12.1	Administrata Publike në Nivel Qendror	37
9.12.1.1	Përshkrimi	37
9.12.1.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	37
9.12.1.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale.....	37
9.12.1.4	Skema.....	38
9.12.2	Subjektet e Administratës Publike në Nivel Rajonal	38
9.12.2.1	Përshkrimi	38
9.12.2.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	38
9.12.2.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale.....	39
9.12.2.4	Skema.....	39
9.12.3	Institucionet e Pavarura	40
9.12.3.1	Përshkrimi	40
9.12.3.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	40
9.12.3.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale.....	40
9.12.3.4	Skema.....	40
9.13	Hapësira.....	41
9.13.1	Përshkrimi.....	41
9.13.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	41
9.13.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	41
9.13.4	Skema	41
9.14	Spektori Arsimor	42
9.14.1	Përshkrimi.....	42
9.14.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	42
9.14.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	42
9.14.4	Skema	42
9.15	Turizmi	43
9.15.1	Përshkrimi.....	43
9.15.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	43
9.15.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	43
9.15.4	Skema	43

9.16	Spektori Postar dhe Shërbimet e Korrierit.....	44
9.16.1	Përshkrimi.....	44
9.16.2	Kritere të Përgjithshme Sektoriale	44
9.16.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	44
9.16.4	Skema	45
9.17	Menaxhimi i Mbetjeve.....	45
9.17.1	Përshkrimi.....	45
9.17.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	45
9.17.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	45
9.17.4	Skema	46
9.18	Prodhimi	47
9.18.1	Përshkrimi.....	47
9.18.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	47
9.18.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	47
9.18.4	Skema	48
9.19	Ofruesit e Shërbimeve Digjitale	48
9.19.1	Përshkrimi.....	48
9.19.2	Kriteret e Përgjithshme Sektoriale	48
9.19.3	Kriteret e Veçanta Sektoriale	49
9.19.4	Skema	49
Shtojca 1	– Skema logjike – OSE –	50
	Përshkrim.....	50

Lista e Figurave

Figura 1	Skema e hapave të ndjekur për klasifikimin e shërbimev/infrastrukturave sipas sektorëve..	11
Figura 2	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Energjisë	15
Figura 3	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit –Ajrur.....	17
Figura 4	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit—Hekurudhor	19
Figura 5	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit –Detar	21
Figura 6	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit—Rrugor	22
Figura 7	Klasifikimi i Sektorit Bankar.....	25
Figura 8	Klasifikimi i Sektorit të Infrastruktura e Tregjeve Financiare.....	27
Figura 9	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Shëndetësisë	29
Figura 10	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Furnizimit me Ujë të Pijshëm.....	31
Figura 11	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Ujërave të Zeza	32
Figura 12	Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Infrastrukturës Digjitale.....	34
Figura 13	Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të TIK.....	36

Figura 14 Klasifikimi i Shërbimeve të Administratës Publike në Nivel Qendror	38
Figura 15 Klasifikimi i Shërbimeve të Subjekteve të Administratës Publike në nivel Rajonal	39
Figura 16 Klasifikimi i Shërbimeve të Institucioneve të Pavarura	40
Figura 17 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Hapësirës.....	41
Figura 18 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Edukimit	42
Figura 19 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Turizmi	43
Figura 20 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit Postar	45
Figura 21 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Mbetjeve	46
Figura 22 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Prodhimi	48
Figura 23 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Ofruesit të Shërbimeve Digjitale.....	49
Figura 24 Skema logjike -OSE-.....	50

Lista e Tabelave

Tabela 1 Sektorë me kritikalitet të lartë	12
Tabela 2 Sektorë të tjerë kritik	13

1 HYRJE

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (**AKSK**) është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi¹ në fushën e sigurisë kibernetike. Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë del në pah nevoja për ngritjen e standarteve të sigurisë së informacionit.

Metodologjia për identifikimin, klasifikimin dhe kategorizimin e shërbimeve digjitale në të gjithë fushat e ekonomisë dhe sigurisë së vendit është një domosdoshmëri.

Subjektet, të cilat do të identifikohen në zbatim të përcaktimeve të parashikuara në këtë metodologji do të jenë subjekt i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga ligji 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, mbi:

1. Marrjen dhe implementimin e masave të nevojshme të sigurisë kibernetike,
2. Raportimin e incidenteve të sigurisë kibernetike
3. Menaxhimin e rrezikut kibernetik, etj.

Operatorët e sektorëve të parashtruar në aneksin 1 dhe 2 të ligjit 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” e marra në shqyrtim për vlerësimin e kritikalisht të shërbimeve që ofrojnë do të klasifikohen në dy kategori:

- a) operator të infrastrukturës kritike të informacionit.
- b) operator i infrastrukturës së rëndësishme të informacionit.

Për këtë klasifikim do të merren në konsideratë kriteret dhe pragjet paraprakisht të përcaktuara.

Disa nga kriteret dhe treguesit që do të vlerësohen gjatë procesit të identifikimit dhe klasifikimit të shërbimit përfshijnë:

1. Varësinë kibernetike (*kriter përjashtues*)
2. Operatori është ofrues i vetëm i shërbimit.
3. Numri i personave të prekur.
4. Ndikimin ekonomik, shëndetësor, mjedisor, sigurinë publike.
5. Shpërndarja gjeografike.
6. Varësinë sektoriale dhe ndër-sektoriale.

¹ Në mbështetje të Ligjit nr.25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”

Gjatë analizës së sektorëve kritik për identifikimin e shërbimeve përkatëse duhet të merret parasysh korniza ligjore sektoriale, sipas rastit, për të vlerësuar llojet e shërbimeve, mënyrën si rregullohen dhe autoritetet rregullatorë dhe mbikëqyrëse.

Metodologjia merr në konsideratë nevojën për të realizuar ndarjen në dy kategori operatorësh, kritik dhe të rëndësishëm, për të siguruar një ekuilibër të drejtë midis kërkesave për masat e sigurisë kibernetike që duhet të zbatojnë operatorët për të mbrojtur infrastrukturën e informacionit, dhe impaktin që shërbimi i ofruar nga operatori ka në siguri, ekonomi dhe shoqëri.

2 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj metodologjie është mbrojtja e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nëpërmjet standardizimit të procesit të identifikimit të shërbimeve/infrastrukturave në operatorë sipas sektorëve të përcaktuar në Ligjin e Sigurisë Kibernetike.

3 OBJEKTI

Objekt i kësaj metodologjie është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për identifikimin dhe kategorizimin e shërbimeve të operatorëve të infrastrukturave të informacionit në kritikë dhe të rëndësishëm.

4 PËRKUFIZIME

Në kuptim të kësaj metodologjie, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike**, (AKSK) është institucioni përgjegjës për sigurinë kibernetike sipas përcaktimeve të ligjit nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.
- **Infrastrukturë Kritike e Informacionit**: është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, të zotëruara nga një autoritet publik ose privat, që ofrojnë shërbime, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.
- **Infrastrukturë e Rëndësishme e Informacionit**: është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit të zotëruara nga një autoritet publik ose privat, i cili nuk është pjesë e

infrastrukturës kritike të informacionit, por që mund të rrezikojë apo të kufizojë ofrimin e shërbimit dhe vazhdimësinë e punës, në rastin e cenimit të sigurisë së informacionit.

- **Operator i Infrastrukturës Kritike të Informacionit:** Do të quhet cdo person fizik ose juridik, i cili administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligj.
- **Operator i Infrastrukturës së Rëndësishme të Informacionit:** Do të quhet cdo person fizik ose juridik, i cili administron infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligj.
- **Varësi Kibernetike:** Do të quhet çdo shërbim i cili ofrohet përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- **Skema “OSE”:** i referohet modelit matematikor ku në rast së një prej kriterëve e klasifikon shërbimin si kritik, atëhere automatikisht shërbimi klasifikohet si kritik dhe nuk vijohet më tej me klasifikimin e tij. Ndërkohë që në rastet kur nga kriteri i plotësuar, shërbimi klasifikohet si i rëndësishëm, kërkimi vijon më tej. Nëse nuk gjendet deri në fund të paktën një kriter kritik, atëhere automatikisht shërbimi klasifikohet si i rëndësishëm. Për më tepër, shikoni Shtojcën nr. 1
- **Shërbim digjital:** është çdo shërbim i shoqërisë së informacionit, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për tregtinë elektronike.
- **Transaksion Financiar Digjital** është një shkëmbim monetar që realizohet përmes teknologjive digjitale, duke eliminuar nevojën për ndërveprime fizike dhe dokumente letre. Këto transaksione përfshijnë pagesa online me karta krediti ose debiti, transferime elektronike të fondeve, përdorimin e portofolëve elektronikë dhe shkëmbimin e kriptovalutave, etj.

5 BAZA LIGJORE

Bazuar në përcaktimet e nenit 12, pikat 1, 2, dhe 5 të ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” përcaktohet se:

1. Autoriteti kryen identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit në vazhdimësi, në bashkëpunim dhe në bashkërendim me subjektet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike.
2. Identifikimi i operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, sipas përcaktimeve të bëra në anekset I dhe II të këtij ligji kryhet mbi bazën e një metodologjie, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

5. Lista e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit është konfidenciale, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përditësohet të paktën një herë në dy vjet”.

6 HAPAT E IDENTIFIKIMIT DHE KLASIFIKIMIT TË SHËRBIMEVE / INFRASTRUKTURAVE TË INFORMACIONIT

Procesi i identifikimit dhe klasifikimit të shërbimeve dhe infrastrukturave të informacionit kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

1. Identifikimi i sektorëve dhe nënsektorëve kritikë në nivel kombëtar - sipas përcaktimeve të bëra në Anekset e ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.
2. Identifikimin dhe grupimi i operatorëve në nivel kombëtar që operojnë në secilin sektor/nënsektor, sipas Autoritetit Rregullator ose/edhe Rregjistrin të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. AKSK, pas konsultimit me autoritetet rregullatorë dhe operatorët përkatës kryhen procesin e përcaktimit të kriterëve dhe pragjeve për shërbimet kritike dhe të rëndësishme për të mundësuar kritikalitetin dhe rëndësinë për secilin shërbim. Këto kriterë aplikohen në procesin e identifikimit dhe klasifikimit të shërbimeve brenda secilit sektor/nënsektor.
4. Identifikimin e shërbimeve në nivel operatori pas konsultimit me operatorët përkatës, përmes vetëdeklarimit si dhe procesit të marrjes së informacioneve të nevojshme për klasifikimin e tyre si kritike ose të rëndësishme, bazuar në pragje.
5. Kriteret për vlerësimin e shërbimeve ndahen në kriterë të përgjithshme dhe sektoriale. Në të gjitha rastet vlerësimi i shërbimeve bazohen në skemën -OR-. Nëse shërbimet nuk klasifikohen sipas kriterit të përgjithshëm, automatikisht ato konsiderohen si të paklasifikueshme.
6. AKSK, pasi kryen procesin e klasifikimit sipas pikës 4, harton listën e shërbimeve kritike apo të rëndësishme sipas operatorëve përkatës

7 KRITERI I PËRGJITHSHËM

Në vijim të informacioneve të vëna në dispozicion nga operatorët, AKSK, për të kryer klasifikimin e shërbimeve/infrastrukturave, do të analizojë të gjithë indikatorët e kritikalitetit apo rëndësisë së infrastrukturës bazuar në pragjet e përcaktuara për çdo sektor në vijim të varësisë kibernetike të shërbimit digjital të ofruar. Në rast se, shërbimi digjital i ofruar nuk ka varësi kibernetike, atëherë shërbimi nuk klasifikohet për analizë të mëtejshme.




Figura 1 Skema e hapave të ndjekur për klasifikimin e shërbimev/infrastrukturave sipas sektorëve

8 IDENTIFIKIMI I SEKTORËVE DHE NËNSEKTORËVE

Shqipëria ka përafuar direktivën nr.2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, “Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian”, e cila ka ndryshuar rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe direktivën (BE) nr. 2018/1972, si dhe ka shfuqizuar direktivën (BE) nr. 2016/1148 NIS2 në ligjin nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”. Në anekset e ligjit nr.24/2025 “ Per sigurinë kibernetike” janë përcaktuar sektorët dhe nënsektorët e mëposhtëm bazuar në kritikalitetin e tyre:

Tabela 1 Sektorë me kritikalitet të lartë

Sektori	Nën-sektori
Energjia	Elektriciteti
	Ngrohja dhe ftohja qendrore
	Nafta
	Gazi
	Hidrogjeni
Transporti	Ajror
	Hekurudhor
	Detar
	Rrugor
Bankar	
Infrastruktura e tregut financiar	
Shëndetësor	
Subjektet që ofrojnë shërbime ose hostojnë sisteme për përpunimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar, që lidhen më sigurinë publike	
Furnizimi me ujë të pijshëm	
Ujërat e zeza	
Infrastruktura digjitale	Shërbime elektronike dhe komunikimi
Menaxhimi i shërbimeve TIK (biznes me biznes)	
Administrata Publike	
Hapësira	

Spektori arsimor	
Turizmi	

Tabela 2 Sektorë të tjerë kritik

Spektori	Nën-sektori
Postar dhe shërbimet e korrierit	
Menaxhimi i Mbetjeve	
Prodhimi, përpunimi dhe shpërndarja e kimikateve	
Prodhimi, procesimi dhe shpërndarja e ushqimit	
Prodhimi	Prodhimi i pajisjeve mjekësore dhe në pajisje mjekësore diagnostikuese vitro
	Prodhim i produkteve kompjutereke, elektronike dhe optike
	Prodhimi i pajisjeve elektrike
	Prodhim makinerish dhe pajisjesh n.e.c.
	Prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkio
	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit
Ofruesit e shërbimeve digjitale	

9 PËRCAKTIMI I PRAGJEVE NË NIVEL SEKTORIAL

9.1 Energjia

9.1.1 Përshkrimi

Sektori i energjisë përfshin një gamë të gjerë shërbimesh që mbështesin prodhimin, shpërndarjen dhe konsumimin e energjisë në forma të ndryshme, duke përfshirë:

- Prodhimi i Energjisë, si Energjia Elektrike apo e Karburanteve Fosile
- Shpërndarja e Energjisë, si Transmetimi i Energjisë Elektrike, Shpërndarja e Energjisë Elektrike, Shpërndarja e Gazit Natyror
- Furnizimi me Energji, si ai me Energji Elektrike dhe me Gaz Natyror
- Shërbimet e Burimeve të Rinovueshme duke përfshirë Instalimi dhe Mirëmbajtja e Paneleve Diellore, Instalimi dhe Mirëmbajtja e Turbinave Eolike

Këto shërbime janë thelbësore për funksionimin e ekonomisë moderne dhe për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve energjetike.

9.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i Transmetimit, i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Gazit (OST^2+OSSH^3+GAZ), klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i Furnizimit me Energji nga Shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik (FSHU⁴), klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i Shoqërive të cilat nuk kanë statusin e mësipërm⁵, por ofrojnë shërbimin e furnizimit për klientë të lidhur me sistemin e transmetimit dhe atij të shpërndarjes në tregun e liberalizuar, klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme për vendin.

² OST: Operatori Sistemit të Transmetimit

³ OSSH: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

⁴ FSHU: Furnizuesi Shërbimit Universal

⁵ Shërbimet nga Shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik

- Shërbimi i Bursës Shqiptare të Energjisë klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimi i prodhimit të energjisë sipas fuqisë së instaluar (kapacitetit gjenerues) përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 15 MW- 100 MW
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 100 MW

9.1.4 Skema




Figura 2 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Energjisë

9.2 Transporti

9.2.1 Ajror

9.2.1.1 Përshkrimi

Sektori i transportit ajror është një komponent kritik i infrastrukturës globale, duke ofruar lidhje të shpejta dhe efikase midis vendeve dhe kontinenteve. Ai përfshin një rrjet të gjerë aeroportesh, linjash ajrore, dhe avionësh modernë, që lejojnë transportin e shpejtë të pasagjerëve dhe mallrave. Ky sektor është jetësor për ekonominë globale, duke mbështetur turizmin, tregtinë ndërkombëtare dhe bizneset e shumta. Përparimet teknologjike dhe përmirësimet e vazhdueshme në siguri dhe shërbime kanë bërë që transporti ajror të jetë më i qasshëm dhe i besueshëm për një numër të madh njerëzish në mbarë botën.

9.2.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfundimisht, në rastin kur nga klasifikimi përmes Kriterëve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i transportimit ajror të mallrave të klasifikuar si të rrëzikshëm⁶ si dhe biologjike, biokimike, nukleare dhe radioaktive⁷ klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.2.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimet aeroportuale të lidhura me udhëtarët përcaktohen sipas:
 - Numrit të fluturimeve në vit referuar vitit paraardhës:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 500-3,000 fluturime/vit

⁶ <https://www.transport-community.org/transport-of-dangerous-goods/>

⁷ https://cbrn-risk-mitigation.net/eork.europa.eu/index_en

- Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 3,000 fluturime/vit
- Numrit vjetor të udhëtarëve të rregjistruar nga viti paraardhës:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 100,000-600,000 udhëtarë/vit
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 600,000 udhëtarë/vit

9.2.1.4 Skema




Figura 3 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit –Ajror

9.3 Hekurudhor

9.3.1 Përshkrimi

Sektori i transportit hekurudhor është një pjesë thelbësore e infrastrukturës transportuese, duke ofruar një mënyrë të qëndrueshme dhe efikase për transportimin e pasagjerëve dhe mallrave mbi distanca të gjata. Ky sektor përfshin rrjete të gjera hekurudhore, stacione trenash dhe trena modernë që përdoren për udhëtime ndërqytetare dhe ndërkombëtare. Transporti hekurudhor është i njohur për kapacitetin e tij të lartë të ngarkesës, duke e bërë atë një alternativë ekologjike ndaj transportit rrugor dhe ajror.

9.3.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfundim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikabiliteti i shërbimit.

- Shërbimi hekurudhor i ofruar nga operatori kombëtar, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i transportit të udhëtarëve përmes sistemit hekurudhor, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i transportimit të mallrave të klasifikuar si të rrezikshëm⁸ përmes sistemit hekurudhor, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i transportimit të mallrave të klasifikuar si jo të rrezikshëm⁹ përmes sistemit hekurudhor, klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin.

9.3.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e transportit hekurudhor, *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale.

⁸ <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

⁹ <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

9.3.4 Skema




Figura 4 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit—Hekurudhor

9.4 Detar

9.4.1 Përshkrimi

Sektori i transportit detar është një shtyllë kryesore e tregtisë ndërkombëtare, duke ofruar një mënyrë efektive dhe ekonomike për transportimin e mallrave të mëdha dhe të rënda përmes oqeanëve dhe deteve. Ky sektor përfshin një flotë të gjerë anijesh tregtare, porte të avancuara dhe rrjete logjistike komplekse që lehtësojnë lëvizjen globale të mallrave. Transporti detar është i njohur për kapacitetin e tij të lartë dhe kosto-efikasitetin, duke bërë të mundur që vende të ndryshme të importojnë dhe eksportojnë sasi të mëdha produktesh me kosto të ulët. Përparimet në teknologjinë e navigimit dhe standardet e sigurisë kanë përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori, duke kontribuar në rritjen e ekonomive globale dhe zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare.

9.4.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme

Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfshirja bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i transportimit detar të mallrave të klasifikuar si, kimike, biologjik, nukleare dhe radioaktive¹⁰, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimet e monitorimit të Autoriteteve Portuale, klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin.

9.4.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara.

- Shërbimet portuale të lidhura direkt/indirekt me qytetarin/biznesin, përcaktohen si më poshtë:
 - Numri vjetor i udhëtarëve detarë të rregjistruar nga viti paraardhës përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 100,000 – 700,000 udhëtarë/vit
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 700,000 udhëtarë/vit
 - Sasia vjetore e mallrave të përpunuara në ton nga viti paraardhës përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 1-3 Milion ton
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 3 Milion ton

¹⁰ https://cbrn-risk-mitigation.network.europa.eu/index_en

9.4.4 Skema




Figura 5 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit –Detar

9.5 Rrugor

9.5.1 Përshkrimi

Sektori i transportit rrugor është një element kyç i infrastrukturës kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar lëvizjen e mallrave dhe pasagjerëve përmes një rrjeti të gjerë rrugësh dhe autostradash. Ky sektor përfshin automjete të ndryshme, si kamionë, autobusa, dhe makina personale, që mundësojnë transportin fleksibël dhe të shpejtë brenda dhe midis qyteteve. Përmirësimet në infrastrukturë, teknologjitë e reja të automjeteve dhe masat e sigurisë rrugore kanë ndihmuar në rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në këtë sektor, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe mobilitetin e popullsisë.

9.5.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kritereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi për menaxhimin dhe monitorimin e trafikut rrugor, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin
- Shërbimi i menaxhimit të transportit urban dhe interurban, klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin

9.5.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për Sektorin e transportit rrugor *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale.

9.5.4 Skema




Figura 6 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Transportit—Rrugor

9.6 Sektori Financiar

9.6.1 Bankar

9.6.1.1 Përshkrimi

Sektori bankar është një shtyllë jetike e ekonomisë globale, duke ofruar shërbime financiare që përfshijnë depozitat, kreditë, dhe menaxhimin e pasurisë për individët dhe bizneset. Bankat mundësojnë qarkullimin e kapitalit si dhe mbështetjen e investimeve dhe konsumit. Përmes një game të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, sektori bankar luan një rol kyç në stabilitetin ekonomik, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës financiare. Inovacionet teknologjike, si bankingu elektronik dhe mobile, kanë përmirësuar aksesin dhe efikasitetin e shërbimeve bankare, duke i bërë ato më të prekshme dhe më të sigurta për një gamë të gjerë klientësh. Sektori Financiar me autoritet Licencues dhe Mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë¹¹ bankar përfshin si më poshtë:

- Banka
- Subjekte financiare jobanka
- Institucionet e Pagesave
- Institucionet e Parasë Elektronike
- Ofruesit e tjerë të Shërbimit të Pagesave
- Shoqëri të Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre

9.6.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikabiliteti i shërbimit.

Kriteret e Përgjithshme sektoriale për sektorin Financiar Bankar, janë si më poshtë:

- Shërbimi bankar i lidhur me depozitën e qytetarit klasifikohet automatikisht shërbim kritik për vendin kritike.
- Shërbimet e Institucioneve Financiare Jo-Bankare të lidhura me publikun ose biznesin, klasifikohen si Shërbime të Rëndësishme për vendin ose të Paklasifikueshme sipas Kriereve të Veçanta Sektoriale në vijim.

¹¹https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Treguesit_e_stabilitetit_financiar/Struktura_e_sektorit_financiar/

- Shërbimet e Shoqërive të Kursim Kreditit të lidhura me publikun ose biznesin, klasifikohen si Shërbime të Rëndësishme për vendin ose të Pakklasifikueshme sipas Krihereve të Veçanta Sektoriale në vijim.
- Nëse institucioni financiar nuk kryen transaksione financiare digjitale¹² për publikun ose biznesin, atëherë shërbimi klasifikohet sipas Krihereve të Veçanta Sektoriale si Shërbim/infrastrukturë e Rëndësishme për vendin ose e Pakklasifikueshme.

9.6.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kriteret janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimet e ofruara për klientët dhe bizneset nga institucionet e mëposhtëme, si:
 - Bankat
 - Subjekte financiare Jo-Bankare
 - Institucionet e Pagesave
 - Institucionet e Parasë Elektronike
 - Ofruesit e tjerë të Shërbimit të Pagesave
 - Shoqëri të Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre

klasifikohen sipas Krihereve të Veçanta Sektoriale si më poshtë:

- Numri i klienteve aktiv të regjistruar në sistemet e operatorit (*në formë direkt ose indirekt¹³*) përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 25.000- 100.000 klientë
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 100.000 klientë
- Qarkullimi vjetor për operatorët referuar vitit paraardhës përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 500,000€ – 1,000,000€
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 1,000,000€

¹² Transaksionet financiare digjitale janë veprime të kryera nëpërmjet teknologjive digjitale, që përfshijnë shkëmbimin e parave ose të aseteve të tjera financiare.

¹³ Indirekt vjen nga baza e të dhënave të klientëve të operatorëve të tjerë që bashkëveprojnë

9.6.1.4 Skema




Figura 7 Klasifikimi i Sektorit Bankar

9.6.2 Infrastruktura e Tregjeve Financiare

9.6.2.1 Përshkrimi

Tregjet financiare janë platforma ku ndodhin transaksionet e aseteve financiare, siç janë aksionet, obligacionet, mallrat dhe valutave. Ato ndihmojnë në përmbushjen e kërkesës dhe ofertës për këto asete, duke lejuar që paratë të rrjedhin nga ata që kanë teprice (investitorët) te ata që kanë nevojë (kompanitë dhe qeveritë).

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare është autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës i tregjeve financiare që mbulon:

- Tregu i Sigurimeve
- Tregu i Titujve
- Tregu i Fondeve të Pensioneve vullnetare
- Tregu i Sipermarreve të Investimeve Kolektive.

9.6.2.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale.

Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriwereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

Kriteret e Përgjithshme sektoriale për sektorin Financiar të Infrastrukturave të Tregjeve Financiare, janë si më poshtë:

- Shërbimi i bursës kombëtare klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin
- Shërbimet e tregut të sigurimeve, klasifikohet automatikisht shërbim i rëndësishëm për vendin
- Shërbimi i Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm ose i Pakklasifikueshëm për vendin, sipas Kriwereve të Veçanta Sektoriale në vijim.
- Shërbimi i Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, klasifikohet si Shërbim i Rëndësishëm ose i Pakklasifikueshëm për vendin, sipas Kriwereve të Veçanta Sektoriale në vijim.

9.6.2.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimi i Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare ose i Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive përcaktohet sipas kriterit të mëposhtëm:
 - Numri i klienteve aktiv të regjistruar që përfitojnë shërbimin (*në formë direkt ose indirekt¹⁴*) me mbi 25.000 klientë, klasifikohet si Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme për vendin.

¹⁴ Indirekt vjen nga baza e të dhënave të klientëve të operatorëve të tjerë që bashkëveprojnë

9.6.2.4 Skema




Figura 8 Klasifikimi i Sektorit të Infrastruktura e Tregjeve Financiare

9.7 Shëndetësia

9.7.1 Përshkrimi

Spektori shëndetësor është një komponent i rëndësishëm i shoqërisë, i dedikuar për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së individëve përmes ofrimit të shërbimeve mjekësore, trajtimeve dhe kujdesit parandalues. Ky sektor përfshin spitale, klinika, institucione kërkimore, profesionistë të kujdesit shëndetësor, dhe teknologji mjekësore, të cilat punojnë së bashku për të diagnostikuar, trajtuar dhe parandaluar sëmundjet. Sektor shëndetësor luan një rol kyç në ruajtjen e shëndetit publik, përballimin e emergjencave shëndetësore dhe mbështetjen e një shoqërie të shëndetshme dhe produktive.

9.7.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kriteret e Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i lidhur me qytetarët në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor¹⁵ klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i lidhur me qytetarët në institucionet shëndetësore publike me shtretër¹⁶ klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i lidhur me qytetarët në Monitorimin dhe Kontrollin në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik dhe në njësitë e kujdesit shëndetësor që përgjigjen për sigurinë shëndetësore, survejancën e sëmundjeve, identifikimin e patogjeneve të rrezikshëm, impaktin e mjedisit në shëndet etj., klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimet e lidhura me prodhuesit e medikamenteve shëndetësore, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i lidhur me qytetarët transfuzionit dhe sigurisë së gjakut klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimet të lidhura me analizat genetike në laboratorët mjekësore, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimet e lidhura me laboratorët in-vitro klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i kontrollit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me anë të qendrës së kontrollit të barnave dhe pajisjeve mjekësore klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i menaxhimit të depoveve farmaceutike klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin.

9.7.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalishtit të shërbimit. Këto kriteret janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalishtit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimet shëndetësore për qytetarët të ofruara nga institucionet private, përcaktohen sipas:
 - Numri i pacientëve të regjistruar të cilët kanë përfituar shërbimin për vitin paraardhës:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 5000 – 15,000 pacientë
 - Shërbim Infrastrukturë Kritike mbi 15,000 pacientë
 - Numri i analizave/ekzaminimeve mjekësore të kryera në laborator për vitin paraardhës:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 50,000-150,000 analiza/ekzaminime
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 150,000 analiza/ekzaminime

¹⁵ Qëndrat shëndetësore, 4 Poliklina të specialiteteve në Tiranë

¹⁶ Të gjithë spitalet që kanë brenda dhe poliklinat e rretheve

9.7.4 Skema




Figura 9 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Shëndetësisë

9.8 Furnizimi me Ujë të Pijshëm

9.8.1 Përshkrimi

Sektori i ujit të pijshëm është një element thelbësor për shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik, duke siguruar furnizimin dhe shpërndarjen e ujit të sigurt dhe të pastër për konsum njerëzor. Ky sektor përfshin infrastrukturën e burimeve ujore, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit, dhe menaxhimin e sistemeve të kanalizimeve dhe ujërave të zeza. Teknologjitë e avancuara dhe praktikat e menaxhimit të qëndrueshëm kanë bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së ujit dhe reduktimin e ndotjes, duke mbrojtur burimet natyrore dhe shëndetin e popullsisë. Furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm të pastër është jetësor për parandalimin e sëmundjeve të transmetuara përmes ujit dhe për garantimin e një cilësie të lartë të jetës për komunitetet anembanë botës.

9.8.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfundimisht bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriterëve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i monitorimit të sigurisë së ujit të pijshëm, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.8.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimi i furnizimit dhe menaxhimit të ujit të pijshëm identifikohet dhe klasifikohet si më poshtë:
 - Numri i abonentëve në nivel rajonal që përfitojnë shërbimin, përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 30,000 – 70,000 abonentë
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 70,000 abonentë

9.8.4 Skema




Figura 10 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Furnizimit me Ujë të Pijshëm

9.9 Ujërat e zeza

9.9.1 Përshkrimi

Sektori i ujërave të zeza është një komponent kyç i infrastrukturës publike, që përfshin mbledhjen, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e ujërave të ndotura nga banesat, bizneset dhe industria. Ky sektor operon për të siguruar që ujërat e zeza të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe efikase për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për të mbrojtur shëndetin publik. Përmes një rrjeti të gjerë kanalizimesh, impianteve të trajtimit dhe teknologjive të avancuara, sektori i ujërave të zeza rikuperon dhe pastron ujërat, duke i bërë ato të përshtatshme për t'u rihedhur në natyrë ose për t'u ripërdorur. Menaxhimi efektiv i këtij sektori është esencial për qëndrueshmërinë mjedisore, ruajtjen e burimeve ujore dhe mirëqenien e komuniteteve.

9.9.2 Kryteret e Përgjithshme Sektoriale

Kryteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kryteret e Veçanta Sektoriale*. Kryteret e Përgjithshme Sektoriale janë kryteret dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kryteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kryteret e Veçanta Sektoriale. Përjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krytereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.9.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e ujërave të zeza, *nuk aploikohen* kriteret e veçanta sektoriale

9.9.4 Skema




Figura 11 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Ujërave të Zeza

9.10 Infrastruktura Digjitale

9.10.1 Përshkrimi

Sektorin e infrastrukturës digjitale është themeli mbi të cilin ndërtohen shërbimet moderne të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, duke mundësuar lidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme. Ky sektor përfshin rrjete të gjera telekomunikacioni, kabllot nëndetare, satelitët, qendrat e të dhënave dhe pajisjet e IT që mbështesin internetin dhe komunikimin global. Infrastruktura digjitale është kritike për funksionimin e ekonomive moderne, duke mbështetur gjithçka, nga komunikimi dhe edukimi, deri tek tregtia elektronike dhe shërbimet publike.

Subjektet të cilët përfshihen në Sektorin e Infrastrukturës Digjitale janë:

- Ofruesit e pikës së shkëmbimit të internetit (Internet Exchange Point)
- Ofruesit e shërbimeve DNS, duke përjashtuar operatorët e serverave të emrave rrënjë (root name servers)
- Operatorët e regjistrave të emrave TLD
- Ofruesit e shërbimeve kompjuterike në renë kompjuterike (cloud computing)
- Ofruesit e shërbimeve të qendrës së të dhënave (Data centre service providers)
- Ofruesit e rrjetit të shpërndarjes së përmbajtjes
- Ofruesit e shërbimeve të besuara

- Ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike
- Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për Publikun
- Ofruesit e shërbimeve vizive të disponueshme për publikun

9.10.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi në nivel kombëtar për administrimin e "*Top Level Domain*" klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin
- Shërbimi "*cloud/on-premise hosting*" i ofruar për hostimin e shërbimeve kritike ose/dhe të rëndësishme të informacionit, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin
- Shërbimi i ofruar nga Ofruesit e rrjetit publik të komunikimeve elektronike për infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin
- Shërbimi i ofruar nga Operatorët e shërbimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg¹⁷ për subjekte ose klientë fundorë, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin
- Shërbimet e Besuara të ofruara nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara (*OKSHB*), klasifikohen automatikisht si shërbime kritike për vendin.
- Shërbimet audio dhe audiovizive¹⁸ të ofruara nga operatorë të kategorizuar si kombëtar, klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm për vendin.

9.10.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimet e operatorëve të infrastrukturës digjitale do të përcaktohen sipas:
 - Numrit të subjekteve të lidhura me infrastruktura "*Internet Exchange Point*" (*IXP*) përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 1- 5 subjekte
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 5 subjekte

¹⁷ Referencë: Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar)

¹⁸ Referencë: Ligj Nr.97/2013 (i ndryshuar)

- Shërbimi i shpërndarjes së përmbajtjes sipas numrit të abonentëve përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 1,000-5,000 abonentë
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 5,000 abonentë
- Shërbimi publik i komunikimeve elektronike sipas numrit të abonentëve përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 1,000-5,000 abonentë
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 5,000 abonentë

9.10.4 Skema




Figura 12 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Infrastrukturës Digjitale

9.11 Menaxhimi i Shërbimeve TIK

9.11.1 Përshkrimi

Sektori i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) luan një rol kyç në mbështetjen dhe optimizimin e operacioneve të biznesit dhe shërbimeve publike përmes zgjidhjeve teknologjike. Ky sektor përfshin ofrimin e shërbimeve IT, menaxhimin e sistemeve të rrjeteve, sigurinë kibernetike, zhvillimin e aplikacioneve dhe mbështetjen teknike. Menaxhimi efektiv i shërbimeve TIK ndihmon organizatat të rrisin efikasitetin, të përmirësojnë produktivitetin dhe të sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve. Përparimet në teknologji dhe praktikat më të mira të menaxhimit të shërbimeve kanë bërë të mundur që ky sektor të jetë një faktor kyç në inovacionin dhe transformimin digjital, duke i lejuar bizneset dhe institucionet publike të reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve në treg dhe kërkesave të klientëve.

9.11.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura Kriteria të Veçanta Sektoriale. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kriteret dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimet TIK të ofruara nga subjekte të kategorizuar si biznes i madh sipas ligjit në fuqi drejt infrastrukturave kritike ose të rëndësishme të informacionit¹⁹, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.11.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e menaxhimit të shërbimeve TIK, *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale.

¹⁹ Infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të përcaktuar sipas ligjit 25/2024 për Sigurinë Kibernetike

9.11.4 Skema




Figura 13 Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të TIK

9.12 Administrata Publike

Administrata Publike përbëhet nga:

- Administrata publike në nivel Qendror
- Administrata publike në nivel Rajonal
- Institucionet e Pavarura

9.12.1 Administrata Publike në Nivel Qendror

9.12.1.1 Përshkrimi

Sektori i administratës publike në nivel qendror është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, menaxhimin e burimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve jetike për qytetarët. Ky sektor përfshin ministritë, agjencitë qeveritare dhe institucionet e tjera qendrore që punojnë për të siguruar mirëqenie, siguri dhe zhvillim ekonomik në shkallë kombëtare. Administrata publike në nivel qendror luan një rol thelbësor në formulimin e legjislacionit, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe koordinimin e programeve publike.

9.12.1.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kritereve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimet e ofruara drejt institucioneve të klasifikuara si infrastruktura informacioni të rëndësishme ose kritike, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik për vendin.
- Shërbimi i ofruar nga portali unik qeveritar, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.12.1.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

- Shërbimet unike të ofruara nga Institucionet Publike për qytetarët, subjektet ose institucionet e infrastrukturave të informacionit të rëndësishëm ose/dhe kritik, përcaktohen si:
 - i. Për qytetarët:
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë 10,000 – 50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë mbi 50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim kritik për vendin.

- ii. Për subjektet:
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë 3,000 – 10,000 subjekte, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë mbi 10,000 biznese, klasifikohet si shërbim kritik për vendin.

9.12.1.4 Skema




Figura 14 Klasifikimi i Shërbimeve të Administratës Publike në Nivel Qendror

9.12.2 Subjektet e Administratës Publike në Nivel Rajonal

9.12.2.1 Përshkrimi

Sektori i administratës publike në nivel rajonal është përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e politikave dhe shërbimeve publike brenda rajoneve të caktuara, duke vepruar si një lidhje kyçe ndërmjet qeverisë qendrore dhe komuniteteve lokale. Ky sektor përfshin autoritetet rajonale, këshillat dhe agjencitë qendrore të cilat koordinojnë zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale për të përmbushur nevojat specifike të rajonit. Administrata publike rajonale luan një rol kritik në përshtatjen e politikave kombëtare me karakteristikat dhe prioritetet lokale, duke siguruar një shpërndarje më efektive dhe të drejtë të burimeve. Efikasiteti dhe bashkëpunimi në këtë nivel janë thelbësorë për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

9.12.2.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Për subjektet e administratës publike në nivel rajonal *nuk aplikohen* kriteret e përgjithshme.

9.12.2.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

Shërbimet e ofruara nga institucionet e pushtetit lokal identifikohen dhe klasifikohen si sipas kritereve dhe pragjeve si më poshtë vijojnë:

- Numri i qytetarëve që marrin shërbime në vit (*në formë direkt ose indirekt*) përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë 10,000 -50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë mbi 50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim Kritik për vendin.

- Numri i subjekteve që marrin shërbime të lidhura me sistemin e taksimit në vit përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë 3,000 – 10,000 subjekte, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë mbi 10,000 subjekte, klasifikohet si shërbim Kritik për vendin.

9.12.2.4 Skema




Figura 15 Klasifikimi i Shërbimeve të Subjekteve të Administratës Publike në nivel Rajonal

9.12.3 Institucionet e Pavarura

9.12.3.1 Përshkrimi

Institucionet e pavarura përfshijnë një grup organesh dhe autoritetesh që veprojnë të pavarura nga qeveria për të siguruar mbikëqyrjen, transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në sektorët e ndryshëm të shoqërisë. Këto institucione kanë rol kritik në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, zbatimin e ligjit, ruajtjen e konkurrencës së drejtë, dhe garantimin e proceseve demokratike. Funksonimi i pavarur dhe i paanshëm i këtyre institucioneve është jetik për forcimin e shtetit të së drejtës, përmirësimin e qeverisjes dhe besimin e publikut në institucionet demokratike.

9.12.3.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura *Kritere të Veçanta Sektoriale*. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfundim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikabiliteti i shërbimit.

- Shërbimet e ofruara nga Institucionet e pavarura, ligjzbatuese, ligjvënëse dhe sigurisë cënimi i informacioneve të të cilave do të ndikonte në interesin dhe sigurinë e publikut si edhe sigurisë kombëtare, klasifikohen automatikisht si shërbime kritike.

9.12.3.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e Institucioneve të Pavarura *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale

9.12.3.4 Skema




Figura 16 Klasifikimi i Shërbimeve të Institucioneve të Pavarura

9.13 Hapësira

9.13.1 Përshkrimi

Sektori i hapësirës është një fushë dinamike dhe e avancuar teknologjikisht që përfshin eksplorimin, studimin dhe shfrytëzimin e hapësirës. Ky sektor përfshin agjencitë hapësinore, kompanitë private, institutet kërkimore dhe universitetet që punojnë së bashku për të zhvilluar teknologji të avancuara, të tilla si satelitët dhe anijet kozmike. Aktivitetet në sektorin e hapësirës përfshijnë misionet e eksplorimit planetar, vëzhgimin e Tokës, komunikimin global dhe hulumtimet shkencore në mjedisin unik të mikrogravitetit. Sektori i hapësirës është gjithashtu një motor i rëndësishëm për inovacionin dhe zhvillimin ekonomik, duke hapur mundësi të reja për industrinë dhe kërkimin shkencor.

9.13.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura Kriteret e Veçanta Sektoriale. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi i ofruar nga Institucionet/Subjektet e lidhura me Gjeohapësirën klasifikohen automatikisht si shërbime kritike për vendin.

9.13.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e hapësirës *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale.

9.13.4 Skema




Figura 17 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Hapësirës

9.14 Sektori Arsimor

9.14.1 Përshkrimi

Sektori arsimor është një komponent thelbësor i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, duke ofruar mundësi për të mësuar dhe zhvilluar aftësi që ndihmojnë individët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ky sektor përfshin institucionet e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe qendrat e trajnimit profesional dhe arsimimit të vazhdueshëm.

9.14.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Për sektorin arsimor, *nuk aplikohen* kriteret e përgjithshme sektoriale.

9.14.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

Shërbimi arsimor para universitar dhe universitar identifikohet dhe klasifikohet si më poshtë:

- Numri aktiv i nxënësve/studentëve të rregjistruar për të gjitha ciklet e studimit përcaktohen si:
 - Shërbim/Infrastrukturë nga i cili përfitojnë 3,000 – 10,000 studentë, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike nga i cili përfitojnë mbi 10,000 studentë, klasifikohet si shërbim Kritik për vendin.

9.14.4 Skema




Figura 18 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Edukimit

9.15 Turizmi

9.15.1 Përshkrimi

Sektori i turizmit është një pjesë vitale e ekonomisë globale, që përfshin udhëtimin dhe eksplorimin e destinacioneve të ndryshme për qëllime rekreative, kulturore, dhe biznesi. Ky sektor përfshin hotelet, restorantet, agjencitë e udhëtimit, transportin dhe atraksionet turistike, të cilat punojnë së bashku për të ofruar përvoja të paharrueshme për vizitorët. Turizmi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, duke krijuar vende pune, nxitur investimet dhe përmirësuar infrastrukturën lokale.

9.15.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Për sektorin e turizmit, *nuk aplikohen* kriteret e përgjithshme sektoriale.

9.15.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara.

Në rastin e sektorit të turizmit klient do të konsiderohet qytetari i cili shpenzon të paktën një natë qëndrim.

- Shërbimi i ofruar nga strukturat akomoduese, nga i cili kanë përfituar mbi 50,000 klientë/vit, klasifikohet si shërbim i Rëndësishëm për vendin.

9.15.4 Skema




Figura 19 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Turizmi

9.16 Sektori Postar dhe Shërbimet e Korrierit

9.16.1 Përshkrimi

Sektori postar dhe shërbimet e korrierit luajnë një rol thelbësor në lehtësimin e komunikimit dhe shkëmbimit të mallrave në nivel lokal dhe global. Ky sektor përfshin ofrimin e shërbimeve tradicionale postare, dërgesave ekspres, dhe logjistikës së avancuar, duke përfshirë shpërndarjen e letrave, pakove dhe dokumenteve. Kompanitë postare dhe të korrierit, si operatorët publikë dhe privatë, përdorin rrjete të gjera infrastrukturore dhe teknologji moderne për të garantuar shpërndarje të shpejtë, të sigurt dhe të besueshme. Përmirësimet në teknologji dhe inovacionet në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit kanë bërë të mundur që ky sektor të përshatet me kërkesat në rritje të tregtisë elektronike dhe globalizimit.

9.16.2 Kriteria të Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura Kriteria të Veçanta Sektoriale. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kriteret dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përrjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Krieteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimi ekskluziv universal postar klasifikohet automatikisht si shërbim kritik për vendin.

9.16.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kriteret janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimet postare përcaktohen sipas:
 - Numrit vjetor i transaksioneve financiare nga shërbimet postare, referuar vitit paraardhës përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 1,000,000 – 2,500,000 transaksione/vit
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 2,500,000 transaksione/vit

9.16.4 Skema




Figura 20 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit Postar

9.17 Menaxhimi i Mbetjeve

9.17.1 Përshkrimi

Sektori i menaxhimit të mbetjeve është jetik për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, duke përfshirë grumbullimin, transportin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme. Ky sektor përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe infrastrukture, nga landfillet dhe impiantet e djegies deri tek qendrat e riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve të rrezikshme. Inovacionet teknologjike dhe praktikatat e qëndrueshme kanë përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të mbetjeve, duke reduktuar ndikimin mjedisor dhe duke promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve. Menaxhimi efektiv i mbetjeve është thelbësor për ruajtjen e burimeve natyrore, uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet, duke kontribuar në një mjedis më të pastër dhe më të qëndrueshëm.

9.17.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Për sektorin e menaxhimit të mbetjeve, *nuk aplikohen* kriteret e përgjithshme sektoriale.

9.17.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara

- Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve identifikohen dhe klasifikohen si më poshtë vijojnë:
 - Pesha maksimale e mbetjeve urbane të djeguara (të incineruara) në ton për 24 orë përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga 20-70 ton
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 70 ton
 - Pesha maksimale e mbetjeve spitalore të djeguara (të incineruara) në ton për 24 orë përcaktohet si:
 - Shërbim/Infrastrukturë e Rëndësishme nga: 1-5 ton
 - Shërbim/Infrastrukturë Kritike mbi 5 ton

9.17.4 Skema




Figura 21 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Mbetjeve

9.18 Prodhimi

9.18.1 Përshkrimi

Sektori i prodhimit është një shtyllë kryesore e ekonomisë globale, duke përfshirë transformimin e lëndëve të para në produkte të gatshme për konsumatorët dhe industrinë. Ky sektor përfshin një gamë të gjerë industrish, nga prodhimi i automjeteve dhe elektronikës deri tek ushqimet dhe tekstilet, dhe përdor teknologji të avancuara dhe procese inovative për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e produkteve. Përmirësimet në automatizim, robotikë dhe inteligjencë artificiale kanë revolucionarizuar prodhimin, duke ulur kostot dhe përmirësuar produktivitetin.

9.18.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura Kriteria të Veçanta Sektoriale. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përfundimisht, në rastin kur nga klasifikimi përmes Kriteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimet për monitorimin dhe kontrollin e produkteve të mbrojtjes së bimëve ose plehërueset që përfshijnë prodhimin, ruajtjen, përdorimin klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme për vendin:
- Shërbimet e prodhimit të produkteve ushqimore të ofruara nga subjektet tregtare të regjistruara në organin tatimor pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të mëdhenj, klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme për vendin.
- Shërbimet për prodhimin e pajisjeve mjekësore dhe të pajisjeve mjekësore diagnostikuese in-vitro; prodhimin e produkteve kompjuterike, elektronike dhe optike; prodhimin e pajisjeve elektrike, prodhimin e makinerive dhe pajisjeve; prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove; prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit; klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme për vendin.

9.18.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e prodhimit, *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale.

9.18.4 Skema




Figura 22 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Prodhimi

9.19 Ofruesit e Shërbimeve Digjitale

9.19.1 Përshkrimi

Sektori i ofruesve të shërbimeve digjitale përfshin kompani dhe organizata që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe produkte përmes platformave digjitale, duke përfshirë internetin dhe pajisjet mobile. Ky sektor përfshin platformat e komunikimit dhe rrjeteve sociale, shërbimet e ruajtjes së të dhënave në re, tregtinë elektronike, pagesat dhe portofolët elektronikë, transmetimin mediatik, edukimin online dhe teknologjitë e informacionit.

9.19.2 Kriteret e Përgjithshme Sektoriale

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura Krite të Veçanta Sektoriale. Kriteret e Përgjithshme Sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë, që nëse një shërbim klasifikohet nga Kriteret e Përgjithshme Sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me Kriteret e Veçanta Sektoriale. Përjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes Kriteve të Përgjithshme Sektoriale, mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

- Shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve digjitale të cilat afektojnë publikun klasifikohen automatikisht të rëndësishme.

9.19.3 Kriteret e Veçanta Sektoriale

Për sektorin e ofruesit të shërbimeve digjitale, *nuk aplikohen* kriteret e veçanta sektoriale

9.19.4 Skema




Figura 23 Klasifikimi i Shërbimeve të Sektorit të Ofruesit të Shërbimeve Digjitale

Shtojca 1 – Skema logjike – OSE –

Përshkrim

Skema logjike "OSE" është një operacion themelor në logjikë dhe shkencë kompjuterike që përdoret për të vlerësuar disa kushte ose deklarata. E shënuar me simbolin "V" ose fjalën "ose", ajo kthehet në të vërtetë nëse të paktën njëri nga kushtet që lidh janë të vërteta, dhe në të pavërtetë vetëm nëse të gjitha kushtet janë të pavërteta. Kjo skemë lejon krijimin e shprehjeve logjike komplekse duke kombinuar deklarata më të thjeshta, duke mundësuar marrjen e vendimeve bazuar në skenarë të ndryshëm ku çdo kusht i vetëm që është i vërtetë është i mjaftueshëm për të plotësuar kushtin e përgjithshëm.

i = Shërbime

j = Kriteria

n_i = Numër mbi l

n_j = Numri Kriteriave mbi l




Figura 24 Skema logjike -OSE-